



## ALBANIAN AMERICAN RELATIONS COUNCIL

Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane (AARC), me t'u certifikuar zgjedhjet e 9 shkurtit nga ana e KQZ, u kërkon partive politike formimin e menjëhershëm të qeverisë së re të Kosovës, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i plotë i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Krijimi në kohë i institucioneve të reja do të riafirmonte kapacitetet shtetëformuese dhe pjekurinë politike të Kosovës, duke përçuar një sinjal të fuqishëm mbarë kombëtarë, edhe tek faktori ndërkombëtar, gjithashtu. Duke qenë se mjedisi global politik po evoluon me shpejtësi, është me rëndësi parësore, që institucionet e Kosovës, të jenë plotësisht të konsoliduara dhe të përgatitura për të adresuar sfidat e menjëhershme dhe afatgjate.

Qeveria e re duhet të marrë një qasje proaktive për avancimin e pozitës së Kosovës. Kjo, duke përfshirë të gjitha përpjekjet e arsyeshme në drejtim të heqjes së masave ndëshkuese të BE-së dhe paraqitjen e një plani strategjik të qartë para Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të inkurajuar investime të e vazhdueshme ekonomike dhe politike në Kosovë.

Duke qenë se Shtetet e Bashkuara mbetet aleati më i afërt dhe më vital i Kosovës, qeveria e re duhet gjithashtu, të ketë prioritet forcimin e pranisë dhe ndikimin sajë në Uashington, D.C. Kjo kërkon zgjerimin e përfaqësimit diplomatik të Kosovës, angazhimin e organizatave lobuese të nivelit të lartë, si dhe sigurimin e takimeve të rregullta të nivelit të lartë, me administratën e re të SHBA-së. Prania e Kosovës në Uashington është zvogëluar dukshëm gjatë viteve të fundit, ndërkohë që një përpjekje e kordinuar për të rikthyer dukshmërinë dhe rëndësinë e saj në axhendën e SHBA-së, është më shumë se e nevojshme.

Këshilli i Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane (AARC), misioni kryesor i cilit, është forcimi i marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe popullit shqiptar, është i gatshëm të bashkëpunojë me institucionet në Uashington, D.C. dhe Prishtinë për të harmonizuar dhe avansuar plotësisht interesat tona të përbashkëta.

24 Mars 2025

New York, NY

*601 Pennsylvania Avenue, NW. South Building, Suite 900 Washington, D.C. 20004*